
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Loti 2: “Blerje materiale reference dhe standarte”

10.12.2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒

“GAMMA” sh.p.k me NIPT K31510153H dhe Adresë: *Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative nr.8, Rruga Dervish Hekali, Ndertesha nr.8*

ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës:Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Marreveshje kuader me disa operatorë ekonomike ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Loti 2: REF-63100-09-30-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 2: “Blerje materiale reference dhe standarte” me fond limit: 1,389,070 (një milionë e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH ose 13 342 (trembëdhjetë mijë e treqind e dyzet e dy) euro pa tvsh.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: dt 26.11.2025.

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 75 datë 02/12/2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “PEGASUS.” sh.p.k

J62903750A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 1,337,500 (një milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “GAMMA” sh.p.k

K31510153H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing sh.p.k

L51512009E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 1,180,000 (një milion e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “PEGASUS.” sh.p.k

J62903750A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 1,337,500 (një milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “PEGASUS.” sh.p.k. me NUIS J62903750A me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë

Arsyet e skualifikimit:

A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.4 të KVK e cila përcakton

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, për të gjithë artikujt objekt i këtij loti.

OE ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania RESTEK PURE CHROMATOGRAPHY me përmbajtje:

I nderuar Zotëri/Zonjë,

Kjo letër shërben si vërtetim se Pegasus Scientific Instruments është autorizuar nga Restek për të ofruar produktet tona për tenderin e mëposhtëm:

Kontraktor: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Projekti: Loti 5: “Blerja e kolonave kromatografike”, Për ISUV

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) www.obp.al

Referenca: **REF-63108-09-30-2025**

Kjo certifikatë është e vlefshme deri më 31 dhjetor 2025.

Ju lutemi na kontaktoni nëse kërkohet informacion shtesë.

Nga sa më lartë OE nuk është autorizuar nga kjo kompani për produktin nr.3 të lotit 2 (Restex standart mix Pesticide (9x1ml viale) dhe si rrjedhim nuk plotëson kriterin e mësipërm.

OE skualifikohet për mospërmbushje të kriterëve të vecanta për kualifikim.

2. ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing sh.p.k

L51512009E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 1,180,000 (një milion e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH
e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

“Operatori ekonomik ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing sh.p.k, **me NUIS L51512009E** me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë:

Arsyet e skualifikimit:

A. OE nuk plotëson Pikën 2.3.4 të KVK e cila përcakton

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij, për të gjithë artikujt objekt i këtij loti.

OE ka deklaruar në ofertën teknike prodhues të artikujve 1 dhe 2 kompaninë “AGILENT” dhe për artikullin nr. 3 kompaninë RESTEK ndërkohë ka ngarkuar në SPE 2 autorizime prodhuesish përkatësisht:

- Autorizim nga kompania LGC Standards GmbH
- Autorizim nga kompania CPAchem Ltd. Bulgaria

Pra OE nuk ka sjell autorizim nga kompanitë e deklaruara prodhuese të produkteve që ofron duke mos plotësuar kërkesën e mësipërme.

B. OE nuk plotëson Pikën 2.3.3 të KVK e cila përcakton

3. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

- Nga verifikimi I dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga OE rezulton se për artikullin nr.1 (Agilent standart ICP-MS) OE ka ngarkuar fletë analizë nga prodhuesi Agilent Technologies për produkte të hedhura në treg në datë 15 mars 2015 dhe me datë skadence 30 shtator 2016 dhe certifikatë analizë nga CPA Chem pa datë.

Nga sa më lartë OE nuk ka ngarkuar katalog ose skedë teknike për këtë product sic përcaktohet në DST.

- Për artikullin nr. 2 (Agilent standart mix pesticide) OE ka sjell certifikatat e përbërjes së secilit kit të pesticideve (8 mix) nga prodhuesi Agilent Technologies për produkte të prodhuara në vitin 2012 dhe me skadence vitin 2013.

Pra dokumentacioni I mësipërm nuk I përket produkteve që ky operator ofron të cilat duhet të jenë me afat skadence 1 (nje) vit nga data e dorezimit. Afati i skadences për artikuj që e kanë shelflife (jetegjatesine) me pak se nje vit duhet qe ne momentin e dorezimit te jete jo me pak se 2/3 e shelf life (jetëgjatësisë).

OE skualifikohet për mosplotësim të Kriteve të vecanta për kualifikim.

Në vijim, në zbatim të pikës 3, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KVO bëri kontrollin aritmetik të ofertës ekonomike të kualifikuar nga ku rezultoi se ofertt e paraqitur nuk ka gabime aritmetike.

Në vijim, në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur;

$N = 1$

$O1 = 1,300,000,$

$PR = 75\% \text{ e } FL = 1,041,802.50 \text{ lekë pa TVSH}$

$O1 \text{ me e madhe se } PR$

Nga përlogaritja rezultoi se nuk është anomalisht e ulët.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. "GAMMA" sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K31510153H
Numri i NIPT-it

Vlera 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerjeve të Përqëndrura sha brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit.

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)